



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**



**Komuna e Drenasit**

Zyra e Kryetarit

01 Nr 030/01-31698 dt. 29.06 2022

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

**V e n d i m**

Për emërimin e koordinatorit për zhvillimin e Planit të Integritetit

- I. Koordinator për zhvillimin e Planit të Integritetit për vitet 2022-2026, Shaban Dobra.
- II. Koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur, (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës, përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcakton fushat e rrezikut dhe bënë identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve.
- III. Obligohen të gjitha drejtoritë/sectorët që të bashkëpunojnë me koordinatorin për të ofruar të gjitha të dhënat dhe dokumentet që kanë të bëjnë me zbatimin e Planit të Integritetit.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të komunës.



**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

Iu dërgohet:

- Zyres së Kryetarit;
- Koordinatorit;
- Të gjitha Drejtorive Komunale;
- Arkivit të komunës së Drenasit.